



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**Ae.nr.97/19**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Mahir Tutuli dhe Qerim Ademaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses N.SH. ["N..."] me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim avokati [Z.N] nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ["S..."] me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim [A.N], për kompensim dëmi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës e paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike II.EK.nr.474/17 e datës 08/02/2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **28/02/2020**, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pa themeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve ["S..."] me seli në Prishtinë dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike II.Ek.nr.474/17 e datës 08/02/2019.

### **A r s y e t i m**

Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin ankimor II.Ek.nr.474/17 e datës 08/02/2019, në piken I të dispozitivit ka vendosur që të aprovoj pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses N.SH. ["N..."] me seli në Prishtinë dhe ka detyruar të paditurën Kompaninë e Sigurimeve ["S..."] me seli në Prishtinë, që t'ia paguaj paditëses shumën prej 2,665.69 euro, në emër të kompensimit të dëmit material, me kamat ligjore prej 12 % duke llogaritur nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim e deri në pagesën definitive, ndërsa në piken II të dispozitivit ka vendosur që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar pjesa e kërkesëpadisë në shume prej 795.00 euro, që konsiston në emër të marrjes së automjetit me qira dhe në piken III të dispozitivit ka vendosur që të detyron të paditurën, që t'ia paguaj paditëses shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 699.00

euro, të gjitha këto në afat kohore prej 7 ditësh, duke llogaritur nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

Kundër aktgjykimit të ankimuar e paditura në afatin ligjor, ka paraqitur ankesë për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur paditësja.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

#### **-Ankesat e të paditurës është e pa themeltë.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja N.SH. ["N..."] me seli në Prishtinë, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 18/10/2017, ka paraqitur padi për kompensim dëmi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ["S..."] me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura, që të paguaj dëmin e pësuar në aksidentin e trafikut me datën 24/06/2017, dhe t'ia paguaj shumën prej 3,985.62 euro, me kamat ligjore prej 12 % duke llogaritur nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim e deri në pagesën definitive si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilën e ka miratuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses duke arsyetuar se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë së deri te aksidenti i komunikacionit ka ardhur me fajin e drejtuesit të automjetit të markës "Skoda Picao", me [targa të regjistrimit ...], i siguruar të e paditura. Mandej, në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar theksohet se në bazë të ekspertizës së makinerisë të punuar nga [N.SH], është vërtetuar lartësia e kërkesëpadisë në shumë prej 2,667.00 euro. Gjykata e shkallës së parë ia ka falur besimin ekspertizës së makinerisë, me arsyetim se ekspertiza përmban elementet e nevojshme të dhënë mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsyeve të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerëson si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore dhe mbi bazën

e kësaj gjendje faktike ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, duke u bazuar në nenin 136.1, 159, 169 paragrafi 1 të LMD-së dhe nenin 26.6 të Ligjit për Sigurimet e Detyrueshme nga Auto përgjegjësia, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka marr konform nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nuk i ka pranuar pretendimet e ankuesit për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara gjykata ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe atë duke u bazuar në ekspertizën e makinerisë e cila ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike se dëmi i shkaktuar në automjetin e paditëses arrin vlerën prej 2,665.69 euro, të cilin mendim eksperti përkatës e ka mbrojtur gjatë seancës gjyqësore, ndërsa me këtë vlerësim të ekspertit është pajtuar edhe e paditura Kompania e Sigurimeve ["S..."] me seli në Prishtinë, respektivisht gjatë shqyrtimit gjyqësorë nuk ka propozuar nxirjen e ndonjë ekspertize tjetër gjyqësore, që eventualisht do të vërtetonte një gjendje tjetër faktike, nga ajo të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e provave të administruara.

Gjykata e shkallës së parë gjithashtu drejt e ka zbatuar dispozitat procedural të nenit 452 të LPK-së, kur ka vendosur për shpenzimet e procedurës duke pasur parasysh suksesin e arritur në procedurë të cilat shpenzime kanë qenë të domosdoshme për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike dhe këto shpenzime të pranuar gjejnë mbështetje në Tarifën e Odes së Avokatëve të Kosovës, të datës 18/03/2017 dhe atë në numrin tarifar 6 dhe 7, duke pasur parasysh vlerën e kontestit deri në shumën 10.000 euro.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore përkitazi me lartësinë e normës së kamatës, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara, ngase neni 26, pika 6, i Ligjit mbi Sigurimin e Detyruar nga Auto përgjegjësia, përcakton lartësinë e kamatës prej 12% nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim. Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë ia ka njohur kamatën nga data e parashtrimit të kërkesës të e paditura, andaj gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike duke dhënë arsye të mjaftueshme, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjyqimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e aktgjyqimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave të nenit 195 paragrafi 1 pika (d) dhe nenit 200 e LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**-Departamenti për Çështje Ekonomike-**  
**Ae.nr.97/19, me datën 28/02/2020**

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari  
Liridon Maloku, d.v